Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 03.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 27.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "2A Group shpk" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 03.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Kërkojmë rishqyrtimin e kritereve të Dosjes së Tenderit për stafin profesional, përkatësisht pikave 3, 5, 6 dhe 7, pasi vlerësojmë se disa nga kërkesat e përcaktuara janë tepër specifike dhe mund të kufizojnë konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.
Në veçanti, kundërshtojmë kërkesën për certifikim shtesë si ekspert i GIS-it, Auditor i Energjisë në Ndriçimin Publik, menaxhim të projektit të ndriçimit publik SMART, si dhe certifikimet ESRx dhe FPP për ekonomistin, pasi kërkojmë që këto kërkesa të arsyetohen në raport me domosdoshmërinë e tyre për realizimin e kontratës dhe të mos përbëjnë kufizim të panevojshëm për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Konkretisht, vërejmë se për një numër të madh të makinerive janë përcaktuar intervale të ngushta të peshës, si p.sh. 14–16 ton, 26–30 ton, 23–25 ton, 21.5–22.5 ton, 15.5–17.5 ton dhe 18.5–19.5 ton. Gjithashtu, kërkohen disa makineri të të njëjtit lloj, me intervale të ndryshme të peshës, si ekskavatorë, ngarkues, finisherë dhe cilindra për ngjeshje apo shtrirje të asfaltit.

Për më tepër, kërkohen pajisje me konfigurime të posaçme dhe kombinime të funksioneve, si makineri të pajisura njëkohësisht me lugë, fshesë dhe pirun, pajisje për shtrimin e bankinave dhe rigollave me GPS dhe nivelizues automatik, si dhe pajisje të specializuara për pastrimin e pahive elastike dhe shenjave të komunikacionit.

Këto kërkesa, nëse nuk mbështeten në nevoja konkrete dhe objektivisht të arsyetuara të projektit, mund të kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë që kanë mundësi të ofertojnë, duke përjashtuar makineri funksionalisht ekuivalente, të cilat mund t'i përmbushin kërkesat e kontratës edhe nëse kanë dallime të vogla në peshë ose në konfigurimin teknik.

Po ashtu, kërkesa për posedimin e njëkohshëm të një numri kaq të madh të makinerive dhe pajisjeve të specializuara kërkon një vlerësim të veçantë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të tyre me natyrën, vëllimin dhe dinamikën e punimeve që do të realizohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pajisjet që mund të përdoren vetëm në faza të caktuara të punimeve ose që mund të zëvendësohen me pajisje të tjera me funksion dhe kapacitet të barasvlershëm.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

Të ofrojë arsyetim teknik për përcaktimin e intervaleve specifike dhe të ngushta të peshës për secilën kategori të makinerive, duke shpjeguar nevojën konkrete për kufijtë minimalë dhe maksimalë të përcaktuar.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net